

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6809  
E hënë, 23 janar 2023  
çmimi 0.40

## Weber: Fshehtësia e dialogut, burim i krizave



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PAS VËRSHIMEVE, KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA VIZITUAR KOMUNËN E SKENDERAJT DHE TË MITROVICËS

## KËRKOHEM FOND EMERGJENT PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET



Kryeministri Albin Kurti ka vizituar të dielën komunën e Skenderajt dhe të Mitrovicës për ta parë nga afër gjendjen në këto dy komuna pas vërshimeve. Kryeministri ka theksuar para gazetarëve se nga ajo që ka parë ka dëme

të konsiderueshme materiale. "Janë dëmtuar ndërtesa dhe infrastruktura publike, shtëpi banimi, ferma bujqësore dhe biznese", ka thënë ai, duke shtuar se qeveria dhe komunat po punojnë për

mbështetjen e qytetarëve dhe për tejkalimin e kësaj situatë. Ndërkaq Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka kërkuar të dielën nga Qeveria e Kosovës t'ua mundësojë një fond emergjent komunave

## WALKERI KËRKON GJYKATË SPECIALE PËR VUÇIQIN: UÇK-JA S'KISHTE ZINXHIR KOMANDUES

FAQE 3



## IKSHPK-ja, THIRRJE QYTETARËVE TË JENË TË KUJDESSHËM ME UJIN E PIJSHËM

FAQE 5

NË VEND TË REFUZIMIT TË OFENDIMEVE MASIVE PUBLIKE NDAJ DRENICËS NË KËTO DITË TË RËNDA TË VËRSHIMEVE

Poezi

## E DI KU TË DHEMB DRENICË



Muhamet MAVRAJ

Kurrë nuk të lanë me çu krye  
E kurrë kryet nuk ta ulën

E di ku të dhemb Drenicë

Tani në ujë a në lot deri në fyt  
Notojnë legjendat e patregueme

Veshu pak orë e Zanës  
se m'i shiton sytë kur të shoh

Lotët tu  
janë pasqyra e nderit  
Ku befasi e zbulojnë veten  
Ndërgjegjet e fshehta  
e të qëllonjë ty nga trishtimi

Nuk ke faj ti  
që Je kapitulli i parë i lirisë

Prishtinë, 21.01.2023

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**EKONOMI**  
SI MUND TË NGADALËSOHET INFLACIONI?  
F. 07

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Osmani në Sofje: Provokatorët nuk do të lejohen të hyjnë në Maqedoni të Veriut

SHKUP, 22 JANAR - Të gjithë ata që provokojnë marrëdhëniet ndërshtetërore apo mohojnë identitetin maqedonas nuk do të lejohen të hyjnë në Maqedoninë e Veriut, ka deklaruar në Sofje ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, pasi ka vizituar në spital një përfaqësues të qendrës bullgare "Car Boris Treti" nga Ohri.

Hristijan Pendikov ishte sulmuar fizikisht të enjten, më 19 janar. Sulmi ndodhi para zyrave të këtij klubi në Ohër, ndërkohë që hetimet ende nuk kanë përcaktuar nëse ai është sulmuar për shkak të mosmarrëveshjeve personale apo për shkak të shtetësisë së tij

bullgare.

Para medieve bullgare, Osmani tha se bullgarët në Maqedoninë e Veriut do të kenë të njëjtat të drejta si të gjitha komunitetet e tjera, por i porositi politikanët, si eurodeputetin Angel Xhambaskit dhe Kostadin Kostadinovi të partisë "Rimëkëmbja", se nuk kanë vend në Maqedoni të Veriut, ashtu sikur nuk ka vend edhe për politikanët e tjerë bullgarë që, sipas tij, fyejnë popullin maqedonas. "Ne nuk do ta lejojmë mohimin e komunitetit bullgar në Maqedoni të Veriut, por nuk do të lejojmë as mohimin e popullit maqedonas, prandaj dua të dërgoj një mesazh që



provokimet të ndalen. Pra, çdo ardhje në Maqedoni të Veriut me qëllim të fyerjes së popullit maqedonas, mohimit të popullit maqedonas, do ta trajtojmë seriozisht dhe kjo do të jetë ardhja e fundit në Republikën e Maqedonisë së Veriut", tha Osmani.

Ndërkaq, ministri i Jashtëm i

Bullgarisë, Nikolaj Milkov, kërkoi që të ndalet gjuha e urrejtjes nga pala maqedonase. "Dhuna nuk ka vend në Bashkimin Evropian", tha Milkov, pa specifikuar nëse incidenti i fundit do të nënkuptojë veto të re bullgare. Bullgaria, si shtet anëtar i BE-së, vitin e kaluar hoqi veton

ndaj Shkupit duke mundësuar nisjen e bisedimeve të anëtarësimit mes BE-së dhe Maqedonisë së Veriut. Vetoja ishte vendosur në nëntor të vitit 2020 për shkak të kontesteve mes dy vendeve për gjuhën, identitetin dhe historinë maqedonase.

Tensionet mes Shkupit dhe Sofjes janë ngritur në tre muajt e fundit pas hapjes së klubeve bullgare në Manastir dhe Ohër, që u kundërshtuan nga pala maqedonase pasi mbajnë emrat e Car Borisit të Tretë dhe Vanço Mihajlovit, personalitete bullgare që kanë luftuar për bashkimin e territoreve të Maqedonisë së Veriut me Bullgarinë.

## Polonia kritikon Gjermaninë lidhur me tanket për Ukrainën

VARSHAVË, 22 JANAR - Kryeministri i Polonisë më 22 janar kritikoi vendimin e Gjermanisë për të mos furnizuar Ukrainën me tanke Leopard, duke thënë se ky qëndrim i Berlinit është "i papranueshëm".

Berlini është treguar hezitues për të dërguar tanke të rënda apo për t'i lejuar shtetet e tjera që të transferojnë tanke të tilla në Ukrainë. "Qëndrimi i Gjermanisë është i papranueshëm. Ka kaluar pothuajse një vit që nga fillimi i luftës. Njerëz të pafajshëm po vdesin çdo ditë", tha kryeministri polak Mateusz



Morawiecki për agjencinë PAP. "Bombat ruse po shkatërrojnë qytetet ukrainase. Po goditen caqet civile, gratë dhe fëmijët po vriten", shtoi ai.

Të premtën afër 50 shtete u pajtuan që t'i japin Kievit ndihmë ushtarake në vlerë prej qindra miliarda dollarësh, përfshirë edhe

autoblinda dhe municione të nevojshme për t'i zbrapsur forcat ruse.

Por, ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, tha se, pavarësisht prej pritjeve të mëdha, "ne ende nuk mund të themi se kur do të merret vendimi dhe se çfarë vendimi do të jetë sa iu përket tankeve Leopard".

Gjermania prodhon tanket Leopard dhe kryeministri i Polonisë tha se po pret "një qëndrim të qartë" nga Berlini nëse shtetet që kanë tanke Leopard mund t'ia japin ato Kievit.

Polonia, po ashtu, ka njoftuar

se është e gatshme të dërgojë në Ukrainë 14 tanke Leopard dhe për këtë çështje tha se po e diskuton edhe me 15 shtete të tjera.

Nëse Berlini refuzon që ta furnizojë Ukrainën me tanke, "ne do të ngremë një koalicion të vogël" të shteteve që janë të gatshme të dhurojnë disa prej pajisjeve të tyre moderne, tankeve të tyre moderne", tha Morawiecki.

Përmes një deklaratë të përbashkët, të shtunën ministrat e Jashtëm të tri shteteve të Baltikut i bënë thirrje Gjermanisë "t'i japë tani tanke Leopard Ukrainës".

## Në shtëpinë e Bidenit zbulohen dokumente të tjera të klasifikuara

WASHINGTON, 22 JANAR - Hetuesit e Departamentit amerikan të Drejtësisë kanë gjetur gjashtë dokumente shtesë të klasifikuara gjatë kontrolleve 13-orëshe në shtëpinë e presidentit Joe Biden në Delauer, tha avokati i presidentit.

Disa prej dokumenteve që janë gjetur në pronën në Uillington të premtën, datonin nga koha kur Biden ishte senator, ndërkaq të tjerat i përkisnin periudhës kur ai shërbeu si nënpresident në administratën e Barack Obamës.

Avokati Bob Bauer tha se "shënime të shkruara personalisht me dorë" dhe "materiale të tjera" po ashtu janë marrë nga autoritetet. Bideni dhe gruaja e tij nuk ishin në shtëpi në kohën kur u bënë kontrollet.

Presidenti amerikan Biden ofroi

qasje "në shtëpinë e tij në mënyrë që Departamenti i Drejtësisë të kryente kontrolle të të gjithë pronës për të gjetur dokumente të mundshme të kohës kur Bideni ishte nënpresident apo dokumente të mundshme të klasifikuara", tha Bauer përmes një deklaratë të publikuar të shtunën.

Ish-presidenti amerikan Donald Trump po përballë me një hetim penal nën dyshimet se nuk ka mbajtur në mënyrë jo të duhur dokumentet e klasifikuara. Më herët gjatë këtij muaji, avokatët e Bidenit njoftuan se më 2 nëntor kishin gjetur grupin e parë të dokumenteve të klasifikuara. Këto materiale ishin zbuluar në Qendrën Penn Biden, një institut që presidenti amerikan kishte themeluar në Uashington.

Grupi i dytë i dokumenteve u gjet më 20 dhjetor në garazhin e shtëpisë së tij në Uillington, ndërkaq një tjetër dokument u gjet në depon e shtëpisë së tij më 12 janar, thanë avokatët e presidentit.

Pasi u zbuluan dokumentet, Bideni tha se ekipi i tij menjëherë i dorëzoi në Arkivat Kombëtare dhe në Departamentin e Drejtësisë. Ende është e paqartë se pse Bideni i kishte mbajtur këto dokumente. Sipas ligjeve, dokumentet e Shtëpisë së Bardhë duhet t'u dorëzohen Arkivave Kombëtare sapo ta mbarojë mandatin një administratë.

Këshilltari i posaçëm, Robert Hur, është emëruar për t'i udhëhequr hetimet sesi ishin mbajtur këto dokumente të ndjeshme.



Gjetja e dokumenteve shtesë dhe hetimit të gjatë mund të jetë një kokëçarje politike për Bidenin, i cili pritet të deklarohet nëse do të garojë edhe për një mandat presidencial.

Ekipi i Bidenit ka thënë se presidenti po bashkëpunon me Departamentin e Drejtësisë për këtë çështje.

Zbulimi i dokumenteve vjen teksa ish-presidenti Trump po hetohet për mënyrën sesi ka

mbajtur qindra dokumente të klasifikuara në shtëpinë e tij në Florida, pasi kishte refuzuar t'i dorëzonte ato.

Trumpi dhe avokatët e tij kishin rezistuar t'i dorëzonin dokumentet deri kur Byroja Federale e Hetimeve (FBI) bastisi shtëpinë e tij në Florida në gushtin e kaluar. Ai ka argumentuar se FBI-ja po e trajton në mënyrë më favorizuese Bidenin.

## Walkeri kërkon Gjykatë Speciale për Vuçiqin: UÇK-ja s'kishte zinxhir komandues

PRISHTINË, 22 JANAR - Ambasadori William Walker ka folur për gjykimin në Hagë, ku po mbahen në paraburgim që dy vjet e më shumë krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai thotë se është i mllefosur nga këmbëngulja e ndërkombëtarëve që të ketë një prokuror special për të shqyrtuar krime të pretenduara nga UÇK-ja. Walkeri ka shtuar se dihet se kush ka kryer krime lufte në Kosovë. Ata, sipas tij, janë policia e ushtria serbe. "Jam shumë i mllefosur nga këmbëngulja e bashkësisë ndërkombëtare që të ketë një prokuror special në Hagë për t'i shqyrtuar krimet e luftës të kryera nga UÇK-ja dhe duke pretenduar se Hashim Thaçi ishte komandant suprem i UÇK-së. Shumica e krimeve të



luftës që janë kryer këtu janë kryer nga trupat serbe, policia serbe, ushtria serbe dhe njësitë speciale serbe", ka thënë Walker për "The Geopost".

Ai ka thënë se zinxhir komandues kishte në qeverinë e Millosheviqit e jo në UÇK. Në krye të zinxhirit komandues të Millosheviqit ishte Vuçiqi

andaj, sipas Walkerit, duhet të ketë Gjykatë Speciale edhe për të. "Vuçiqi ishte në zinxhirin komandues të qeverisë së Millosheviqit. Duhet të ketë një

Gjykatë Speciale për ta. Ky ishte një zinxhir i vërtetë komandues. UÇK-ja realisht nuk e kishte, ishte e çorganizuar, njëri komandant ishte në Pejë, tjetri në Podujevë, nuk ishin zotë lufte, por e kishin nën kontroll zonën e tyre, nuk merrnin urdhra. Pra, gjërat e këqija që ndodhën më pas, mendoj se i bënë civilët që u kthyen këtu, ata panë se çfarë kishte ndodhur me fshatin e tyre, nuk u pëlqente dikush që ishte bashkëpunëtor ose që kishte marrë pjesë në një krim. Ja ku u kryen krime, por nuk ishin krime lufte nga lart. Shikoni se çfarë bëri ushtria serbe, policia serbe, njerëzit që ishin nën komandën e Millosheviqit dhe Vuçiqit. Unë jam shumë kritik ndaj asaj që po ndodh në Hagë tani", ka thënë Walkeri.


## Shqipëri, mbi 1 700 hektarë tokë e përmbytur, një rrugë e bllokuar nga ortekët

TI RANË, 22 JANAR - Në Shqipëri është rritur numri i sipërfaqes së tokës të përmbytur si pasojë e reshjeve të shiut dhe motit të keq. Rreth 1 750 hektarë tokë janë në ujë, nga të cilat 1 220 hektarë në qarkun e Shkodrës, ndërsa pjesa tjetër në qarkun e Lezhës. Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile bëri me dije se si pasojë e prurjeve të shumta vazhdon shkarkimi i kontrolluar në kaskadën e Drinit me 300 metër kub për sekondë. Sipas autoriteteve, lumenjtë janë në nivelin kritik dhe nuk përbëjnë rrezik për përmbytje në zona të tjera. Në veri të Shqipërisë reshjet e borës kanë shkaktuar disa probleme. Rruga Bogë - Theth është e bllokuar si pasojë e ortekëve dhe ndërhyrja

është e pamundur. Ndërsa Rruga e Arbrit, e cila lidh Shqipërinë me Maqedoninë e Veriut, që u bllokua ditën e djeshme për shkak të borës, sot është e kalueshme. Emergjencat Civile njoftuan se të shtunën, më 21 janar, u bllokuan në malin e Tomorrit (në qarkun e Beratit) pesë makina me turistë vendas, ndaj ky institucion bëri apel që të shmangen destinacionet ku ka prani bore dhe akulli në rrugë. Reshjet kanë dëmtuar katër ura në qarqet Shkodër dhe Lezhë. Sipas të dhënave nga Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, pritet që sot dhe nesër të ketë reshje shiu, çka mund ta përkeqësojë situatën. Përveç Shqipërisë, dëme nga vërshimet janë shkaktuar edhe në disa komuna të Kosovës.



## Ish-ministrja e Jashtme: Kosova ta hapë zyrën ndërlidhëse në Ukrainë



PRISHTINË, 22 JANAR - Ish-ministrja e Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka kërkuar nga MPJ që të hapë zyrë ndërlidhëse në Kiev të Ukrainës. "Edhe pas dy vjetësh shohim se MPJ nuk ka strategji lobimi për mirëmbajtjen dhe thellimin e raporteve bilaterale ekzistuese me shtete njohëse, e as iniciativa të reja për të filluar një

komunikim të thjeshtë bilateral me shtete mosnjohëse. Për shembull, MPJ do të duhej të kërkojë nga lidhshipi i Ukrainës (ndoshta përmes ministres së Jashtme Olta Xhaçka apo ministrit të Jashtëm Bujar Osmani) të fillojë bisedimet për të hapur një Zyrë Ndërlidhëse të Kosovës në Kiev, sidomos tani që edhe Shqipëria e hapi

Ambasadën e saj aty, dhe ka një bashkim të të dyja shteteve (Kosovë e Ukrainë) në polin anti-Rusi", ka shkruar në "Facebook" Haradinaj-Stublla. Ajo ka theksuar se Kosova nuk e kapitalizoi aspak vendimin e Serbisë për mosvendosje të sanksioneve ndaj Rusisë dhe ky mbase do të jetë momenti i fundit për të filluar.

## Komuna e Skenderajt dhe OVLUÇK-ja nderojnë familjen Jashari në përvjetorin e 25 të sulmit të dytë

Skenderaj, 22 janar - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, nënkryetari Sami Lushtaku, kryesuesja Adelina Spahiu, ish-komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkëlufëtarë të

komandantit legjendar Adem Jashari, anëtarët e kuvendit komunal, udhëheqësit e Shoqatave të Dala nga Lufta dhe pjesëtarët e auto-klubeve, kanë bërë të dielën homazhe në Kompleksin Përkujtimor

"Adem Jashari", në nderim të sakrificës sublime të Familjes Jashari, në përvjetorin e 25-të të sulmit të dytë mbi këtë familje emblematike shqiptare. Homazhe kanë bërë edhe udhëheqësit e OVLUÇK-së.





PAS VËRSHIMEVE, KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA VIZITUAR KOMUNËN E SKENDERAJT DHE TË MITROVICËS

## Kërkohet fond emergjent për dëmet e shkaktuara nga vërshimet

Kryeministri Albin Kurti ka vizituar të dielën komunën e Skenderajt dhe të Mitrovicës për ta parë nga afër gjendjen në këto dy komuna pas vërshimeve. Kryeministri ka theksuar para gazetarëve se nga ajo që ka parë ka dëme të konsiderueshme materiale. “Janë dëmtuar ndërtesa e infrastrukturë publike, shtëpi banimi, ferma bujqësore dhe biznese”, ka thënë ai, duke shtuar se qeveria dhe komunat po punojnë bashkë për mbështetjen e qytetarëve dhe tejkalimin e kësaj situatë. Ndërkaq Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka kërkuar të dielën nga Qeveria e Kosovës që t’ua mundësojë një fond emergjent komunave

Përveç Skenderajt, Kurti vizitoi edhe Mitrovicën. “Në Skenderaj dhe Mitrovicë isha sot bashkë me ministrat Mehaj e Krasniqi, dhe zëvendësministrat Gashani e Dobra. Duke ju falënderuar angazhimit dhe solidaritetit të të gjithëve me njëri-tjetrin nuk kemi jetë të humbura nga vërshimet. Ka

dëme të konsiderueshme materiale: janë dëmtuar ndërtesa e infrastrukturë publike, shtëpi banimi, ferma bujqësore e biznese. Në Skenderaj janë rrënuar ose dëmtuar nëntë ura të vogla kurse në Llaushë vizituam një fermer të cilit i janë mbytur mbi 10 mijë pula. Nëpër muret e

ndërtesave kishte ngelur lart vija e gjurmës deri ku kishte arritur përmbytja ndërkaq brigjet e deformuara të lumenjve si dhe arat rrotull janë përplot bërllug. Vërshimi në fshatin Lisicë të Mitrovicës, sipas banorëve, është pasojë e shtyrjes për afër 300 metra të rrjedhës së lumit Ibër si

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

Pristinë, 22 janar - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka kërkuar të dielën nga Qeveria e Kosovës t’ua mundësojë një fond emergjent komunave. Kjo kërkesë e AKK-së vjen pas vërshimeve që përfshin disa komuna të Kosovës gjatë kësaj jave, që shkaktuan dëme në ekonominë familjare, biznese, infrastrukturë rrugore e të tjera.

Nga vërshimet më të prekura janë komuna Skenderaj, Mitrovicë e Jugut, Istog dhe Klinë. “Vërshimet nuk janë problemi i vetëm, pasi gjatë vitit komunat ballafaqohen edhe me fatkeqësi të tjera

natyrore. Bordi i AKK-së kërkon që fondin emergjent ta menaxhojnë komunat për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve të tyre”, thuhet në një njoftim për medie të AKK-së.

Në komunat e prekura nga vërshimet janë formuar komisione për evidentimin e dëmeve. Komuna e Skenderaj ka ofruar për qytetarët e prekur nga vërshimet produkte ushqimore dhe higjienike. Sipas kryetarit të Skenderajt, Fadil Nura, dëmet nga vërshimet janë shumë të mëdha, andaj ai gjatë një takimi me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, më 22 janar, kërkoi përkrahjen nga niveli qendror për riparimin e dëmeve.





rezultat i ndërtimit të stadiumit në pjesën veriore të qytetit. Ibri e Sitnica janë bërë bashkë dhe janë shndërruar në liqe. Ka jo pak kafshë të ngordhura, andaj edhe rrezik për epidemi”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka treguar se institucionet po punojnë për t'i sanuar dëmet e shkaktuara, duke premtuar ndihmën e institucioneve. “Pas takimeve me kryetarët e këtyre dy komunave, Fadil Nurën dhe Bedri Hamzën, vizituam bashkë disa vendbanime të përmbytura. Pjesëtarët e FSK-së e të policisë, zjarrfikësve dhe ndërmarrjeve publike, u kanë shpërndarë ushqim, veshmbathje e batanije, barna e pako higjienike, familjeve të evakuara. Qeveria dhe komunat po punojnë bashkë për mbështetjen e qytetarëve dhe tejkalimin e kësaj situatë”, ka bërë me dije kryeministri Kurti.

Sipas njoftimit të qeverisë, në Skenderaj janë dërguar cisterna

me ujë të pijshëm, por edhe batanije dhe ka nisur edhe ofrimi i tri shujtave për 500 persona. Ndërkaq, në Mitrovicë të Jugut rreth 100 persona janë zhvendosur nga shtëpitë dhe janë akomoduar në vende të ndryshme. Edhe në këtë komunë janë dërguar cisterna me ujë të pijshëm, teksa zjarrfikësit po vazhdojnë punën për hapjen e kanaleve anësore për qarkullimin e ujërave dhe rënien e nivelit të ujit.

Ndërkaq, komuna e Klinës ka ftuar qytetarët të paraqiten në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjente nga data 23 deri me 30 janar për plotësimin e aplikacioneve për vlerësimin e dëmeve.

Komuna e Mitrovicës ka bërë me dije se ka marrë përsipër që brenda mundësive financiare të bëhet kompensimi i dëmeve por, sipas saj, në një gjendje të tillë presin reflektim dhe mbështetje edhe nga niveli qendror.

## Situatë e qetë pas vërshimeve

Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka njoftuar se pas ndaljes së reshjeve të shiut situata është e qetë, teksa ka shtuar se po bëhen intervenime të ndryshme në zona të caktuara. Nga vërshimet më të prekura janë komunat: Skenderaj, Mitrovicë e Jugut dhe Istog.

Vërshimet kanë dëmtuar ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore dhe infrastrukturën rrugore.

Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, sipas MBP-së, është duke vazhduar angazhimin me pompa për largimin e ujit në shtëpitë dhe në zonat ku ka pasur përmbytje nga vërshimet. “Aktualisht po intervenohet edhe në infrastrukturën e prekur nga vërshimet në mënyrë që shërbimet dhe qarkullimi për qytetarët të normalizohet. Në fokus vazhdojnë të jenë kërkesat dhe nevojat e familjeve që janë

evakuuar në dy ditët e fundit”, thuhet në njoftimin e MBP-së.

Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme thuhet se do ta vazhdojë koordinimin ndërinstytucional me qëllim të reagimit në rastet e nevojshme dhe ndaj kërkesave të mundshme që do t'i pranojë nga komunat dhe nga qytetarët.

Policia e Kosovës tha se për shkak se ende ka të reshura të dobëta shiu, niveli i ujit në lumenj është ende i lartë, prandaj ka vazhduar monitorimin e situatës. “Sipas raportimeve të sotme, nivel më të shtuar të ujërave si pasojë e reshjeve të ditëve të fundit ka në pjesën veriore dhe veriperëndimore të vendit”, u tha në njoftim. Sipas policisë, në rajone të tjera nuk ka lumenj që kanë dalë nga shtrati dhe nuk është raportuar për vërshime.

Shirat e rrëmbyeshëm shkaktojnë shpesh vërshime në Kosovë.

Sipas Institutit, reshjet e shiut me intensitet të ndryshuar pritet të

vazhdojnë edhe gjatë ditëve në vazhdim deri më 25 janar.

## Weber: Fshehtësia e dialogut, burim i krizave

PRISHTINË, 22 JANAR - Mosdhënia e detajeve nga takimet e ndërmjetësuesve perëndimorë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, janë sinjale se ende ekziston bllokada në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Kështu thotë Bodo Weber, ekspert për Ballkanin dhe bashkëpunëtor i lartë i Këshillit për Politikën e Demokratizimit në Berlin.

Të premtën, më 20 janar, Prishtinën dhe Beogradin i ka vizituar i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, i shoqëruar nga i dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, i dërguari i Francës, Emmanuel Bonne, i dërguari i Gjermanisë, Jens Plotner, dhe këshilltari i Qeverisë italiane, Francesco Talo.

Temë e diskutimeve ishte propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për të cilin ndërmjetësuesit nga

Perëndimi theksuan se kanë prituri nga Prishtina më shumë mirëkuptim rreth mundësive që ofron propozimi. Ndërkaq në Beograd, sipas tyre, kanë vënë re një “qasje të përgjegjshme dhe gatishmëri për vendime të vështira”.

Weber konsideron se problemi në këto bisedime është se ato po mbahen prapa dyerve të mbyllura, ndërkohë që “edhe më tej ka rezistencë në tentimin për të arritur përparim lidhur me propozimin e BE-së ose të ashtuquajturit propozim gjermano-francez”.

“Përderisa është e paqartë dhe jopublike prapavija e kësaj qasjeje, është vështirë të vlerësohet se a ekziston vërtet ndonjë dinamikë, ndonjë plan që shërbehet me disa afate që janë me kontekst të caktuar dhe të rëndësishëm ndërkombëtar apo e gjithë kjo është vetëm përpjekje për t'i ofruar palët në mënyrë që të arrihet deri të një përparim i shpejtë”, thotë Weber. Ai shpreh mendimin se shprehja “kompromis”, që përdoret nga ana



e ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, në kontekstin e mundësisë së arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është “tejet e

rrëzishme”. “Kjo ka qenë pika kryesore e Vuçiqit dhe e regjimit serb në bisedimet rreth propozimit për shkëmbimin e territoreve”. Ai nuk i përjashton krizat eventuale në

veri të Kosovës përderisa, siç thotë ai, nuk publikohen marrëveshjet dhe të mos u lihet palëve mundësia që t'i interpretojnë ndryshe-ndryshe.

# Letër presidentit të Turqisë, Erdogan

Nga: Sali BISLIMI

Mbi themelet e shtetit të Kosovës nuk do të mund ta vendosni islamit politik, i cili rrezikon dhe izolon shtetin tonë të ri.

Perandoria Osmane me ofertën e ndërmjetësimit të paqes për konfliktin serbo-kosovar është pabesia e radhës dhe këtu dukeni manipulator. Oferta juaj na shqetëson për mossinqeritetin që keni.

Duke qenë ish-pushtues i vendit tonë në një të kaluar të gjatë në histori, nuk mund të jeni dashamirës i vendit tonë.

Ju jeni duke u përpjekur të vendosni një regjim të islamizimit të pastër dhe të ashpër, duke vënë në pikëpyetje themelet e shtetit tonë demokratik.

Kanë kaluar shtatë vjet qëkur udhëheqësit dhe zyrtarët islamikë vendosën gurthemelin e xhamisë së re qendrore të Prishtinës pa pyetur askënd, që

sot është duke ardhur si anktë për kryeqytetin tonë.

Xhamitë tuaja të ndërtuara për qëllime politike që gati janë 1 000, nuk janë shtëpi të zotit, por kazerma për luftime kundër shqiptarëve dhe Perëndimit. Ato një ditë do të derdhin gjak.

Islamizimi i Kosovës është në kundërshtim me procesin e integritetit evropian.

Ne si qytetarë të Kosovës duhet të qëndrojmë vigjilentë dhe do ta mbrojmë lirinë politike dhe fetare në vlera perëndimore.

Kosova nuk do të jetë kurrë peng i Turqisë.

Investimet kapitale i keni në Serbi dhe me trosha bukë nuk mund ta mashtroni popullin e Kosovës.

E dua paqen në vendin tim, zoti president Erdogan. Largohuni nga Kosova sa nuk është bërë vonë!

*(Autori është 'Ambasador i Paqes' dhe drejtor i OJQ 'Zëri Perëndimor i Kosovës')*



## IKShPK-ja, thirrje qytetarët të jenë të kujdesshëm me ujin e pijshëm



PRISHTINË, 22 JANAR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) u ka thënë qytetarëve ta vlojnë ujin para se ta konsumojnë ose të shfrytëzojnë burime të sigurta dhe ujë të ambalazhuar. Kjo për shkak se, siç ka thënë IKShPK më 22 janar, si pasojë e vërshimeve janë regjistruar vlera të shtuara të turbullirës në shumë burime të ujit. IKShPK ka thënë se vlami i ujit është procedurë e thjeshtë dhe e zakonshme, por ka shtuar se

tani është e domosdoshme të parandalohen shpërthime epidemike. "Ekipet e Institutit Kombëtar janë në gjendje gatishmërie dhe vazhdojnë monitorimin e rregullt dhe janë në dispozicion me të gjitha kapacitetet për ta ruajtur situatën stabile dhe për çdo përkeqësim të situatës epidemiologjike do të informoheni në kohë reale", thuhet në njoftim.

Po ashtu, Qeveria e Kosovës ka bërë me dije se ka ngritur

nivelin e gatishmërisë me të gjitha institucionet përkatëse. Kompania e ujës jellësit rajonal "Prishtina" ka njoftuar më 22 janar se për shkak të reshjeve të dendura me vërshime, vazhdon të ketë turbullirë të lartë të ujit në kanalën e Ibrit. Kjo kompani njoftoi se fabrika e ujit në Shkabaj është jashtë funksionit dhe do të ketë reduktime të ujit në disa pjesë të qytetit të Fushë-Kosovës, Prishtinës, Obiliqit dhe Drenasit.

## Osmani pret ambasadorin Walker: Faleminderit që ishe zëri ynë në ditët tona më të vështira!

PRISHTINË, 22 JANAR - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur në takim mikun e Republikës së Kosovës, ambasadorin William Walker. Në një takim të përzemërt, presidentja Osmani i shprehu edhe njëherë mirënjohjen e thellë ambasadorit Walker për vendosmërinë e tij për të treguar të vërtetën ndërkombëtarisht kur populli i Kosovës po përjetonte ditët më të errëta si

dhe për angazhimin e vazhdueshëm për ta ndihmuar Kosovën në rrugën e shtetndërtimit. "Qytetarët e Kosovës do t'u jenë përjetësisht mirënjohës. Faleminderit që ishe zëri ynë në ditët tona më të vështira e mirënjohje të pafund për miqësinë e sinqertë e të pakursyer për vendin dhe qytetarët tanë!", ka theksuar presidentja Osmani.



## Të hënën nuk mbahet mësim në katër shkolla të Skenderajt

Skenderaj, 22 janar - Pas vërshimeve me dëme materiale, të hënën nuk mbahet mësim në katër shkolla të Skenderajt. Lajmin e bëri me dije

drejtori i Arsimit në Skenderaj, Kastriot Duraku, përmes një njoftimi në "Facebook". "Mësimi nuk do të mbahet në shkollat: Gjinnazi 'Hamëz Jashari',

ShMLP 'Anton Çetta', Shfmu 'IsmetRrahmani' Aqarevë dhe Shfmu 'Bashkim Sadiku' në Tushilë, të cilat për shkak të dëmeve të mëdha nga përmytjet nuk

kemi arritur ende t'i kthejmë në gjendje normale", ka shkruar Duraku. Në shkollat e tjera do të mbahet mësim i rregullt.



# Si mund të ngadalësohet inflacioni?



**PRISHTINË, 22 JANAR** - Inflacioni do të jetë një nga problematikat kryesore me të cilat Kosova do të vazhdojë të përballet edhe në vitin 2023, thonë njohësit e çështjeve ekonomike. Megjithatë, ata presin që trendi i rritjes të jetë më i ngadalshëm se në vitin 2022, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit të shënojë rënie. Një arsye për këtë optimizëm është stabilizimi i zinxhirit të furnizimeve.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, norma mesatare vjetore e inflacionit në vend për vitin 2022 ka qenë 11.6 për qind. Në muajin dhjetor ajo ka arritur në 12.1 për qind. Këto shifra janë të larta, thotë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna. Por, sipas tij, këtë inflacion nuk e kanë krijuar bizneset në Kosovë - ato e kanë importuar atë pasi kanë blerë me çmime më të larta, qoftë lëndë të parë, gjysmëprodukte apo produkte finale. "Ky inflacion në Kosovë është dyshifror dhe është shumë i lartë. Në qoftë se hyjmë në strukturën e inflacionit, ne shohim se produktet ushqimore kanë dominuar dhe kanë shkuar me ngritje të çmimeve deri në 40 për qind ose ka raste edhe deri në 50 për qind. Kjo ka qenë shumë shqetësuese për këtë vit [2022]". "Për sa i përket vitit 2023, unë jam më optimist - sidomos në gjysmën e dytë të vitit, mbase edhe nga muaji prill ose maj të nisë të bjerë inflacioni, po ashtu edhe çmimet", thotë Rafuna për "Radion Evropa e Lirë".

Rritja e çmimeve në Kosovë, por edhe gjetiu në botë, ka nisur në fund të vitit 2021 për shkak të

çrregullimeve në tregje që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit. Rritja ka vazhduar me ritëm më të shpejtë nga shkurti i vitit të kaluar, kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës. Rritje kanë pësuar pothuajse të gjitha produktet e shërbimet në Kosovë - nga buka e mielli deri te rryma e patundshmëritë. Paga mesatare në vend është rreth 480 euro, ndërsa ajo minimale sillet nga 130 në 170 euro.

Në disa anketa që ka realizuar REL me qytetarë në Prishtinë, shumë kanë thënë se e kanë më të vështirë t'i sigurojnë produktet e nevojshme.

Berim Ramosaj, profesor i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se edhe gjatë vitit 2023 Kosova do të përballet me inflacion, por trendi i rritjes do të jetë më i ngadalshëm. Ai vlerëson se inflacioni do të mund të futet në korniza të kontrollueshme vetëm pas një ose dy vjetësh. Por, për të pasur një pasqyrë reale lidhur me inflacionin në Kosovë, nuk duhet bazuar vetëm në çmimet e ngritura të produkteve bazike për qytetarët, por edhe te sasia e parave në qarkullim, thotë Ramosaj.

Ai thekson se Banka Qendrore e Kosovës nuk e ka të drejtën e kontrollimit të sasisë së parave që janë në qarkullim sepse, pavarësisht se në Kosovë monedhë zyrtare është euroja, vendi nuk është pjesë e Eurozonës dhe, rrjedhimisht, nuk e gëzon të drejtën e vendimmarrjes për sasinë e parave në qarkullim. "Ne do të

jemi në trend të rritjes ose të rritjes më të ngadalshme të inflacionit, ngjashëm sikurse vendet e tjera në rajon. Por, te ne reflekton më shumë. Ka vende ku inflacioni e stimulon zhvillimin, ngase është një lloj përshpejtuesi në kuptimin e rritjes së sasisë së parave, rritjes së kërkesës, rritjes ekonomike... Te ne refleksionet nuk janë aq pozitive, duke marrë parasysh se bilanci tregtar i Kosovës është një mjaft i papërshtatshëm, në kuptimin e raportit eksport-import", thotë Ramosaj për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave, nga janari deri në nëntor të vitit 2022 Kosova ka eksportuar produkte në vlerë prej rreth 850 milionë eurosh, ndërsa ka importuar produkte në vlerë mbi pesë miliardë euro. Rrjedhimisht, deficitin tregtar i Kosovës për muajt janar-nëntor 2022 ka arritur në 4.2 miliardë euro.

## "Të ulen tatimet"

Kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna, thotë se në shumë vende të botës, qeveritë kanë ndërmarrë masa për zbutjen e efekteve të inflacionit, duke i ndihmuar qytetarët e tyre edhe me subvencione.

Subvencionimin e grupeve të caktuara shoqërore e ka bërë edhe Qeveria e Kosovës përmes pakove të ndryshme financiare. Në një periudhë ajo ka vendosur çmime tavan - apo maksimale - për derivatet e naftës.

Rafuna thotë se qeveria mund të

marrë edhe masa të tjera që mund të ndikojnë në zbutjen e inflacionit. "Për shembull, ulja e tatimeve. Në këtë kohë, të uljet për shembull tatimi i akcizës ose të hiqet fare për disa produkte - në qoftë se kjo ndikon në uljen e çmimeve. Pastaj, mundësia për t'i subvencionuar kompanitë, të cilat subvencione më pas mund t'ua bartin punëtorëve të tyre. Ka shumë masa, por është vetëm çështje e analizave. Gjithmonë, thirrja jonë si OEK ka qenë që të ulemi bashkë me ministrinë përkatëse dhe ta përgatitim një pako për bizneset. Duke i ndihmuar bizneset, i ndihmojmë edhe qytetarët", thotë Rafuna. REL kontaktoi Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë e Financave për t'i pyetur se si planifikojnë ta luftojnë ose menaxhojnë rritjen e inflacionit në vitin 2023, por nuk mori përgjigje prej tyre.

## "Të rriten formaliteti dhe kursimet bankare"

Profesori Ramosaj thotë se ekzistojnë një mori masash që mund të ndikojnë në zbutjen e inflacionit por, sipas tij, Kosova duhet t'u qaset atyre që mund të jenë të zbatueshme për të. Sipas tij, Qeveria e Kosovës, mes të tjerash, duhet t'u qaset politikave të taksave dhe politikave të rritjes ekonomike, duke u bazuar në stimulimin e sektorëve të caktuar që kanë efekt të drejtpërdrejtë në rritje ekonomike.

Hyrja e parave përmes kanaleve joformale në Kosovë, thotë Ramosaj, e pengon zbutjen e

inflacionit. "Zvogëlimi i këtyre sektorëve joformalë, respektivisht rritja e formalitetit në përgjithësi në biznes, është faktor që mund të japë rezultate. Së dyti, nëse ka aq aftësi [Qeveria e Kosovës] që t'i rrisë normat e interesit për kredi dhe, në njëfarë mënyre, ta bëjë atraktiv konceptin e kursimeve... Ka mundësi që një pjesë e madhe e mjeteve të lira të qytetarëve të shkojnë nëpër banka, të kursehen dhe ato nuk krijojnë kërkesë të re në treg. Kjo ka efekt kundër inflacionit, menjëherë", thotë Ramosaj. Ai shton se këto janë masa kozmetike, por që mund të ndikojnë në zbutjen e inflacionit. Sipas një dokumenti të publikuar në tetor të vitit 2022 nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, shkalla e inflacionit për çmimet mesatare për konsumatorë në Kosovë ka qenë 12 për qind, në Maqedoninë e Veriut ka qenë 10.6 për qind, në Shqipëri 6.2 për qind, në Mal të Zi 12.8 për qind, në Serbi 11.5 për qind, në Bosnjë-Hercegovinë 10.5 për qind dhe në Kroaci 9.8 për qind.

Sipas Bankës Botërore, në vitin 2021 Kosova shënoi rritje ekonomike prej 10.5-përqindësh, ndërsa në vitin 2022, rritja ekonomike nuk ishte më shumë se 3.1 për qind. Për vitin 2023 Banka Botërore parashihet që rritja ekonomike në Kosovë të jetë ndërmjet 3 dhe 4 për qind. Banka Qendrore e Kosovës ka paraparë që inflacioni në vitin 2023 të jetë rreth 6.2 për qind. Në Eurozonë, ndërkaq, inflacioni ka prekur rekord në tetor, duke arritur në 10.7 për qind.

# Brenda “Lojës së Fronit” për pasuesin e Vladimir Putinit në Rusi



## Nga Roman ANIN “Worldcrunch”

Rusia renditet sot me të drejte si ndër regjimet më të izoluar dhe më çnjerëzore në botë. Dhe kjo jo vetëm për shkak të luftës, por si pasojë e 2 dekadave të degradimit politik dhe moral të shtetit rus. Klanet që e rrethojnë aktualisht Vladimir Putinin, u ngjajnë grupeve të kriminit të organizuar.

Disa prej tyre komandojnë ushtritë e tyre, si pronari i Grupit Wagner Yevgeny Prigozhin dhe kreu i Rosgvardia, Viktor Zolotov. Të tjerët, si Nikolai Patrushev, kreu i Këshillit të Sigurimit, kanë njësitë e tyre të sigurisë. Dhe çdo klan ka burimet e tij financiare: banka, korporata shtetërore dhe kompani të mëdha. Disa klane zotërojnë rajone të tëra, si Ramzan Kadyrov në Çeçeni. Dhe asnjëri prej tyre nuk i nënshtrohet asnjë ligji.

### Arbitri i Kremlinit

Këto klane nuk janë bashkuar kurrë. Për 20 vite, ata kanë luftuar vazhdimisht kundër njëri-tjetrit për sferat e ndikimit dhe burimeve. Luftërat e tyre mund të quhen konvencionalisht luftëra të ftohta: ato u zhvilluan në hije nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe viktimat – oficerë sigurie, njerëz të biznesit dhe zyrtarë të klaneve kundërshtarë – kanë humbur lirinë por jo jetën e tyre (megjithëse ka pasur përjashtime).

Në gjithë këto vite, Vladimir Putin ka vepruar si një lloj arbitri në konfliktet e rrethit të tij të brendshëm. Ai ka siguruar një ekuilibër të pasigurt fuqie midis fraksioneve ndërluftuese, sepse secili e dinte se pa Putinin, nuk do të kishte ekuilibër, dhe do të shpërthente një luftë e të gjithëve kundër të gjithëve.

Por asgjë nuk e dobëson aq shumë fuqinë e një diktatori sa plakja dhe disfatat ushtarake. Ndërsa afrohet fundi i Vladimir Putinit – qoftë politik apo fizik – luftërat e ftohta për pushtet të klaneve rreth e rrotull tij kanë më shumë gjasa të përshkallëzohen në luftëra të nxehta. Dhe në betejën për atë që do ta pasojë, fituesi nuk do të jetë një klan, por ai që mund të krijojë koalicionin më të fuqishëm.

### Brutaliteti kundër inteligjencës

Skicat e një koalicioni të mundshëm janë shfaqur që pas disa muajsh nga nisja e luftës në Ukrainë: një aleancë midis Prigozhin dhe Kadyrov. Kjo dyshe mund të bashkohet me klanin e kreut të Rosgvardia, Viktor Zolotov, i cili e njeh mirë Prigozhin që nga kohët kur ai ishte “banditi i Shën Petersburgut” dhe është në kontakt të ngushtë me udhëheqësin e Çeçenisë. Le ta quajmë këtë treshe “koalicioni i gjakatarëve”. Përparësitë e saj: brutaliteti, vendosmëria dhe ushtria e tyre e fuqishme e përbashkët.

Një koalicion tjetër që mund të

shfaqet gjatë luftës për pushtet, është aleanca e njerëzve më me ndikim. Miqtë e Vladimir Putin dhe anëtarët e tjerë të KGB-së. Le ta quajmë këtë “koalicionin e miqve”. Sido që të jenë kontradiktat që përçajnë Kovalchuk, Patrushev, Tokarev dhe Timchenko, edhe ata ndihen të kërcënuar nga “koalicioni i gjakatarëve”.

Nëse do të dalë vërtet në skenë një koalicion i tillë, avantazhet e tij të pakushtëzuara do të ishin burimet e mëdha financiare (këta njerëz zotërojnë të gjithë Rusinë), dhe kontrollin mbi shërbimet speciale, që edhe pse janë inferiorë ndaj “ushtrisë së gjakatarëve” sa i përket fuqisë sulmuese, kanë një inteligjencë dhe potencial intelektual shumë më të madh.

### Urrejtja ndaj klasës sunduese dhe Ukrainës

Së fundi, një organizatë e tretë e cila u shfaq menjëherë pas shpërthimit të luftës në Ukrainë, por që nuk e ka gjetur ende udhëheqësin dhe strukturën e vet përfundimtare, është “koalicioni i patriotëve”. Anëtarët e saj nuk e kanë njohur ende veten si komunitet, por lufta ka zgjuar vlerat, urrejtjen dhe aspiratat e përbashkëta.

“Koalicioni i patriotëve” e urren klasën sunduese ruse për korrupsionin dhe humbjet e saj ushtarake. Por nga ana tjetër e refuzon “koalicionin e gjakatarëve” për lidhjet e tyre me qeverinë aktuale, kriminelët dhe Çeçeninë. Ky koalicion ka avantazhe të mëdha.

Ai kundërshton korrupsionin e

qeverisë aktuale dhe e mbështet shkatërrimin e plotë të Ukrainës, një pikëpamje që përputhet me interesat e shumicës dërrmuese të popullsisë ruse.

“Koalicioni i patriotëve” është një kalorës i errët në luftën për pushtet dhe suksesi i tij varet kryesisht nga ai që do të bëhet udhëheqës.

### Miqtë e Putinit kundër gjakatarëve të regjimit

“Koalicioni i miqve” garanton fatin e atyre që janë më pak të etur për gjak: Drejtuesit dhe anëtarët aktivë të klaneve kundërshtarë kanë më shumë arsye që të kenë frikë. E ardhmja e Rusisë do të bjerë në duart e fëmijëve të elitës aktuale. Pra të rinjve që kanë më shumë gjasa të zgjedhin festat e tyre të preferuara në Monako dhe pistat e skive Courchevel mbi idenë për ta kthyer vendin në një Kore të Veriut, duke pasur në kufi një luftë që nuk përfundon kurrë. Le të supozojmë për një moment se fiton “koalicioni i patriotëve”. Në mënyrë të pashmangshme Rusia do të përballej me një diktaturë ushtarake, sepse fitorja në front kërkon një dorë të fortë dhe një luftë të pamëshirshme kundër tradhtarëve në vend. Askush nuk e di se sa do të zgjasë kjo diktaturë.

Për shembull Koreja e Veriut ka qenë në këtë gjendje për më shumë se 70 vjet. Nëse fiton “koalicioni i gjakatarëve”, Perëndimi dhe Kina do të detyrohen t’i përgjigjen një

pyetjeje të ndërlikuar: A do të jenë gati të pranojnë një nga arsenalet më të mëdha bërthamore në botë që të përfundojë në duart e një trinie të bukur: një donzhuan që drejton një orkestër sadistësh të armatosur me varre, një ish-roje sigurie në presidencë i famshëm për aftësitë e tij njohëse dhe një akademik çeçen që pëlqen torturat dhe ekzekutimet pa gjyq?

### Fundi i rrugëtimit për Putinin

Megjithatë kjo lojë për pushtet do të përfundojë një ditë, dhe tashmë është e qartë se Vladimir Putin nuk do të luajë një rol të rëndësishëm në të. Ai ka përjetuar gjënë më të keqe që mund t’i ndodhë një diktatori: në vend të frikës, po trajtohet me përbuzje.

Ai po e kërcënon Perëndimin me raketat e tij, dhe Perëndimi e karikaturon atë si një majmun të varur mbi një buton të armëve bërthamore. Ai shkruan fjalime që zgjasin me orë të tëra, të cilat zëdhënësi i tij për mediat premtan se do t’i shqyrtojë e gjithë bota. Por bota po i jeton si përsiatjet e një të çmenduri që flet me tërbim për fundin e botës.

Ai pozon si mashkulli Alfa në tufën e tij. Por edhe anëtarët e tij më të rinj të regjimit e quajnë atë një frikacak që “trembet hapur për jetën e tij në kulmin e një luftë të madhe dhe të vështirë”. Përballë kësaj stigme, fundi i karrierës apo jetës së tij po i afrohet gjithnjë e më shumë.



# A ecën ndonjëherë evolucioni në drejtimin e kundërt?



Nga Michael DHAR

Evolucioni ka prodhuar tipare komplekse mahnitëse, nga krahët e oktapodit të mbushur me neurone deri tek veshi i gjetarëve. Por a mund të kthehet ndonjëherë evolucioni “prapa”, pra duke i kthyer krijesat komplekse në format e mëparshme, më të thjeshta?

Në të ashtuquajturin evolucion regresiv, organizmat mund të humbasin disa tipare komplekse, duke evoluar kështu “prapa” në forma më të thjeshta. Por ekspertët thonë se në fakt evolucioni nuk ecën në drejtimin e kundërt, në kuptimin e zhbërjes së hapave evolucionarë.

“Shanset që të njëjtat ndryshime evolucionare të zhbëhen duke u rikthyer në gjendjen e dikurshme janë gati të pamundura”- thotë Uilliam Xhefri, biolog në Universitetin e Merilendit, SHBA. Evolucioni regresiv përfshin humbjen e

formave të evoluara më parë të kompleksitetit, thotë Bet Okamura, studiues i shkencave të jetës në Muzeun e Historisë Natyrore në Londër.

Një shembull ekstrem vjen nga mikrozoanët, parazitët me një anatomi shumë të thjeshtë, pa gojë, sistem nervor apo zorrë, dhe me genome shumë të vogla. “Lloji më i thjeshtë i tyre janë në thelb qeliza individuale”- thotë Okamura.

Të klasifikuar për një kohë të gjatë si protozoarë njëqelizorë, u zbulua se mikrozoanët ishin kafshë që kishin pësuar një evolucion regresiv. Ata evoluon nga knidarianët, një grup gjallesash ku përfshihen edhe kandilët e detit, duke humbur shumë karakteristika që nuk i nevojiten më një mënyre jetese parazitare.

Kështu, mikrozoanët mund të duken, të paktën në aspektin morfologjik, se janë rikthyer në një fazë të mëparshme të evolucionit të tyre thotë Okamura. “Ato po shndërrohen

në organizma njëqelizore”- tha ai. Megjithatë, procesi evolucionar nuk i kthen hapat e tij në një evolucionin regresiv thekson Xhefri.

Speciet që banojnë nëpër shpella i nënshtrohen shpesh evolucionit regresiv, duke humbur tiparet e tyre komplekse, si sytë, të cilat nuk nevojiten në mjedis të errëta. Por humbja e syve tek peshqit e shpellave, nuk nënkupton saktësisht një rikthim tek modeli i një paraardhësi të lashtë pa këto organe, thekson më tej Xhefri. Përkundrazi, proceset që kanë prodhuar më parë syrin ndalen pjesërisht, duke e lënë njërin nga sytë e mbetur të tejmbushur me lëkurë. “Gjërat mund të duken sikur po shkojnë në drejtimin e kundërt. Por syri nuk rikthehet në gjendjen e mëparshme. Ai thjesht ndalon së evoluar më tej”- shton eksperti.

Për më tepër, humbja e tipareve komplekse mund të shoqërojnë një rritje më pak të dukshme të kompleksitetit, siç janë parazitët

biokimikë që ata përdorin për të depërtuar brenda bujtësve të tyre shprehet Okamura. “Njerëzit e kanë shumë të lehtë të mendojnë për evolucionin në termat e asaj që shohin me sy... pra cilat janë tiparet morfologjike. Por ka edhe shumë karakteristika të tjera, të cilat ne nuk i shohim në nivelin fiziologjik dhe atë biokimik”- nënvizon ai.

Në rastin e peshqve të shpellave, humbja e syve mund të lërë në hije kompleksitetin alternativ. Organet që reagojnë ndaj dridhjeve shfaqen në sasi të mëdha tek këta lloje peshqish, duke ofruar një mënyrë për të ndjerë më shumë në mjedis të errëta.


Një pjesë e arsyes pse evolucioni nuk rikthehet pas në gjurmët e tij, është se përshtatjet çojnë në ndryshime të tjera, mendon Brajan Golding, biolog në Universitetin Mckmaster në Ontario, Kanada. Dhe kjo e bën shumë të ndërlikuar identifikimin e një ndryshimi

specifik.

“Nëse bëni një ndryshim ...do ta rregulloni mirë atë për t’u përshtatur, dhe kjo përshtatje do të ndërveprojë me gjene të tjera. Nëse e ndryshoni atë, duhet të ndryshohen të gjitha gjenet e tjera në mënyrë që të ndryshojnë evolucionin”- thotë Golding.

Për shembull, tek peshqit e shpellave zhvillimi original i një syri mund të ketë ardhur me ndryshime jo vetëm tek proteinat e nevojshme për sytë, por edhe tek strukturat e kafkës aty pranë. Së fundi, ekspertët paralajmëruan se termi “evolucion regresiv” mund të nënkuptojë në mënyrë mashtruese, se evolucioni ka një qëllim për të krijuar forma më komplekse.

Megjithatë, evolucionin favorizon thjeshte veçoritë që e bëjnë një organizëm më të përshtatshëm për një mjedis të caktuar, thotë Okamura. Në këtë mënyrë, edhe evolucioni regresiv është një evolucion i zakonshëm. / “Livescience” – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Trepça triumfon në derbi ndaj Pejës, Ylli pas vazhdimeve mposhti Vëllaznimin

**PEJË, 22 JANAR** - Trepça ka fituar derbin ndaj Pejës në udhëtim me rezultat 83:91 (20:18, 15:31, 18:23, 30:19), ndeshje e zhvilluar në kuadër të xhiros së 19-të në Prince Caffè Superligë. Verdhezinjtë e nisën ndeshjen më mirë, ku në fillim krijuan epërsi 12:5, por shtatë pikë radhazi nga mysafirët bënë që rezultati të barazohet në 12:12, ndërsa më pas zhvillohet lojë e barabartë, ku çereku i parë përfundon 20:18. Pas një fillimi të barabartë në periudhën e dytë, mitrovicasit ishin dukshëm më të mirë në këtë pjesë, duke u shkëputur dhe për të shkuar në pushim me rezultat 35:49. Mysafirët nuk u ndalën as në periudhën e tretë, ku kishin epërsi deri në 20 pikë për të kontrolluar ndeshjen, kurse rezultati pas 30 minutash ishin 53:72. Në dhjetë minutat e fundit, pejanët tentuan rikthimin e madh, duke ngushtuar rezultatin në vetëm katër pikë 77:81, por nuk arritën

të bëjnë më shumë dhe Trepça triumfoi 83:91. Rodney Purvis shënoi 20 pikë për vendasit, kurse te mysafirët më të dalluarit ishin Will Daniels me 25 pikë e nëntë kërcime, Ken Brown me 21 pikë e gjashtë kërcime dhe Mikaile Tmusiq me 20 pikë e gjashtë kërcime. Peja ka 13 fitore e gjashtë humbje, kurse Trepça dhjetë fitore e nëntë humbje. Golden Eagle Ylli nuk ndalet. Kampioni i Kosovës ka regjistruar fitoren e 15-të radhazi pas katër humbjeve që kishte në fillimi. Në një ndeshje aspak të lehtë, therandasit pas vazhdimeve kanë mundur Vëllaznimin me rezultat 79:76 (13:24, 17:14, 17:11, 19:17, 13:10), në xhiron e 19-të të Prince Caffè Superligës. Vëllaznimi numëron shtatë fitore e 12 humbje. Mysafirët e nisën ndeshjen më mirë me epërsi të dyfishtë 7:14, e më pas e ngritën epërsinë deri në 13 pikë, 11:24, kurse çereku i parë përfundoi 13:24. Në periudhën e dytë, u zhvillua lojë më e



barabartë me vendasit që afronin rezultatit, sidoqoftë, skuadrat shkuan në pushim me shifrat 30:38. Therandasit vazhduan me lojë të mirë në periodën e tretë dhe dalëngadalë shkrinë epërsinë dhe kaluan për herë të parë në avantazh 46:44, kurse rezultati

pas 30 minutash në semafor ishte 47:49. Kjo bëri që dhjetë minutat e fundit të jenë interesant dhe në fund të dy skuadrat kishin mundësinë për fitore dhe ndeshja shkoi në vazhdime (66:66). Edhe në vazhdime u zhvillua lojë interesante, por në fund Ylli u

tregua pak më i vëmendshëm se kuqezinjtë dhe fitoi 79:76. Bashir Ahmed shënoi 19 pikë për vendasit, ndërsa Henrik Sirko shtoi 16 për vendasit, kurse për mysafirët më i miri ishte Damonte Dodd me 14 pikë e 24 kërcime.



## Balkani fiton Superkupën

**BELEK, 22 JANAR** - Kampioni në fuqi, Balkani është fitues i Superkupës së Kosovës, pasi në ndeshjen e zhvilluar në "Titanic Delux" në Belek të Turqisë, e ka mundur fituesen e Kupës së Kosovës, Llapin, me rezultat 1:0. Ndeshja e Superkupës u vendos të luhej në Turqi, pasi të dyja skuadrat ishin në këtë

periudhë në fazë përgatitore në bregdetin turk. Golin e vetëm në këtë duel e realizoi Lumbardh Dellova, në minutën e 62-të. Ai u gjend më së miri para portës së Abdylit, pas harkimit të shkëlqyeshëm të Armend Thaçit nga krahu i djathtë dhe me gjuajtje me kokë e dërgoi topin në rrjetë.

Për Llapin gjërat u vështirësuan në minutën e 28-të, kur Bekim Maliqi u përjashtua me kartonin e kuq (pas dy të verdhëve). Në fund trofeun kapitenit Edvin Kuç ia dorëzoi presidenti Agim Ademi, derisa medaljet për skuadrat i ndanë nënkryetari Bakir Burri dhe anëtarë i KE-së, Xhelal Broja.

## Historike, Kosova kualifikohet për raundin e dytë

**PRISHTINË, 22 JANAR** - Vashat e Përfaqësuesja U17 në volejboll, pas tri fitoreve radhazi të arritura në CEV Kualifikimet e Kampionatit Evropian U17, ka arritur të zë pozitën e pestë, e cila e dërgon tutje në raundin e

dytë kualifikues. Nga shtatë shtete pjesëmarrëse, në raundin e dytë kualifikohen Turqia, Bullgaria, Rumania, Greqia e Kosova. Garat e raundit të dytë kualifikues zhvillohen nga 20-23 prill 2023 dhe mbetet të shihet

cili vend do të jetë organizator dhe çfarë kundërshtarë do të ketë. Ky është moment historik, meqë Kosova U17 bëhet Përfaqësuesja e parë në volejboll që kalon një fazë më tutje.



## Arsenali i Xhakës merr fitore drithëruese ndaj Unitedit

**LONDËR, 22 JANAR** - Arsenali është një skuadër e jashtëzakonshme këtë sezon. Kryesuesja e Premier Ligë ka arritur që të marrë një fitore të madhe 3-2 ndaj Manchester United, në një nga duelet më interesante. Ndeshja nisi në malore për

topçinjtë që e panë veten në disavantazh pas 17 minutash lojë, teksa për Djajtë e Kuq do të shënonte Marcus Rashford. Arsenali do të reagojë menjëherë duke gjetur barazimin pas 7 minutash me Nketiah. Ekipi i Artetas luan

bukur dhe në fillimin e pjesës së dytë do të kalonte në avantazh me një goditje të bukur nga Saka. Unitedi do të rivendoste shpejt barazimin me Lisandro Martínez. Arsenali ngulmoi për të gjetur golin e fitores, teksa do të shpërdoronte raste të

shumta. Në fundin e kohë së rregullt, Nketiah ishte në kohën dhe në vendin e duhur për të devijuar një pasim në kuadrat. Arsenali udhëheq renditjen me 50 pikë, 5 më shumë se City, por ka dhe një sfidë për të rikuperuar.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

